

KËRKESË
Nr. 6917, datë 23.12.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rijetësimi i qendrës së qytetit Delvinë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Delvinë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 10,719,236 (dhjetë milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

TABELA E PASURIVE QE SHPRONESOHEN TE CILAT PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
"Rijetësimi i qendrës së qytetit Delvinë"

Nr.	Pronari		Zona Kadas- trale	Nr. Pasurisë	Lloji i ndërtimit	Sipërfaqe		çmimi		Vlera		Shenime
	Emri	Mbiemri				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	
						m2	m2	lekë	lekë	lekë	lekë	
1	NDUE	KODRA	1464	6 47	Tregëti	200	120	1587	preventiv	317,400	6,551,967	Barrë hipotekore
2	VANGJEL	BARZUKA	1464	6 47	Tregësi	0	120		preventiv		3,849,869	Konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma									317,400	10,401,836	
	VLERA TOTALE										10,719,236	

Shënim: Vlerësimi i objekteve është kryer sipas VKM nr.138, datë 23.03.2000 dhe vlerësimi i truallit është 1587 lek/m2, sipas VKM-së nr.89' datë 03.02.2016.